



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:149721

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05471883

**C.nr.458/2022**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**, gjyqtari Besmir Juniku, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.K nga Rahoveci, të cilën e përfaqëson Av. A.M nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën me autorizim e përfaqëson Av.B.O nga Rahoveci, për shkak të kompensimit të shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse, vlera e kontestit 2,447.33 euro, jashtë shqyrtimit, me datë **19.03.2024** merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.APROVOHET në tërësi si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses F.K nga Rahoveci, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, që paditëses në emër të kompensimit për shpërblim jubilar t’ia paguaj shumën prej 815.78 Euro (tetëqind e pesëmbëdhjetë euro e shtatëdhjetë e tetë cent), në vlerë të 150% të pagës bazë neto (543.85Euro), për 40 vjet përvojë pune dhe në emër të kompensimit të pagesave përcjellëse në emër të pensionimit, t’ia paguaj shumën prej 1,631.55 Euro (një mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një euro e pesëdhjetë e pesë cent), në të cilën llogariten tri paga neto prej 543.85Euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej **2,447.33 Euro** (dymijë e katërqind e dyzetë e shtatë euro e tridhjetë e tre cent), me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë (datë 22.07.2022), e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**II.DETYROHET** e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditëses t’ia paguajë shumën prej **135.00** (njëqind e njëzet e pesë) **€uro**, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja F.K nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson Av. A.M nga Rahoveci, në këtë gjykatë, me datë 22.07.2022 ka parashtuar padi për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse në emër të pensionimit, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim.

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, Av. A.M, në padi ka theksuar se ka qenë e punësuar në pozitën mësimdhënëse në SHML “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec dhe me datë 27.04.2022

është pensionuar. Deri në pensionim kishte përvojë pune 42 (dyzetë e dy) vite, andaj sipas Kontratës Kolektive në fuqi i takon kompensimi i shpërblimit jubilar 150% të pagës bazë dhe 3 (tre) paga përcjellëse në emër të pensionimit. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe ta detyrojë të paditurën Komuna Rahovec – Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses t’ia kompensoj shpërblimin jubilar, për 40 vite të përvojës së punës, në shumën prej 815.75€uro dhe në emër të pagave përcjellëse për pensionim shumën prej 1,631.55€uro ( tri paga nga 543.85€uro), në shumën e përgjithshme prej 2,447.85€uro, me kamatë ligjore prej 8%, prej momentit të ushtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas tarifës së OAK-së.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj Av.B.O, në përgjigje në padi ka theksuar: e kontestoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses në tërësi, ngase konsideron se padia si e tillë është e pathemeltë dhe e pabazuar ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit. Me njoftim për shkëputjen të Kontratës Kolektive të Arsim të datës 2021, MASHT ka shkëputur këtë kontratë me 31.11.2022. MASHT me këtë rast ka shkëputur këtë kontratë njëanshëm bazuar në kornizën ligjore në fuqi pasi që e njëjta është nënshkruar në mungese të bazës ligjore, shpërputhje me dispozitat e rendit publike dhe mungesë të legjitimitetit të palës nënshkruese. Me shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2021 nga ana e MASHT më datën 21.11.2022, padia e paditësve përtej datës 18.04.2020 është e pabazuar. Në bazë të nenit 90 par. 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, është përcaktuar se: *“4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet.”* Në kuptim të kësaj dispozite të Ligjit të Punës, Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë ka qenë në fuqi nga data 18.04.2017 deri më 17.04.2020. Nga kjo rezulton se përtej datës 17.04.2020, kërkesëpadia e paditësit është e pabazë, sepse në këtë periudhë nuk ka pasur Kontratë Kolektive të Arsimit. Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur me datë 22.01.2021 nuk ka efekt retroaktiv, për çka rezulton se e paditura nuk ka detyrim që paditësve t’u paguaj shumat në emër të inflacionit vjetor, respektivisht në emër të kompensimeve tjera sipas dispozitave të kontratës që kanë implikime financiare për periudhën kohore prej datës 18.04.2020. Në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës, të gjitha kërkesat në para nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh. Paditësja ka parashtruar padi në gjykatë, me datë 22.07.2022, në këtë mënyrë e paditura konsideron se kërkesëpadia është parashkruar në tërësi, ngase nga hyrja në fuqi e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me datë 18.04.2017, e deri në parashtrimin e padisë në gjykatë, me datë 22.07.2022, kanë kaluar më shumë se 3 vite. Të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë çështje kontestimore Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është nënshkruar në mes të SBASHK-ut dhe MASHTI-it. Me rastin e lidhjes së kontratave kolektive në mes MASHTI-it dhe SBASHK-ut, në nenin 2 të kontratave janë deleguar kompetenca dhe detyrime për të paditurën, pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë, sepse në përmbajtjen e kontratave kolektive parashihen beneficione të ndryshme për punëtorët e arsimit në Kosovë, siç janë: Shujtat ditore, pagat jubilarë, pagat përcjellëse, kompensimi mbi bazën e kualifikimit apo licencimit dhe detyrime të tjera që përbëjnë kosto të papërbalueshme të shpenzimeve për të paditurën. Andaj, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses F.K nga Rahoveci, për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe pagesës përcjellëse, ta refuzojë në tërësi si të pabazuar ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: Në emër të përgjigjes në padi shumën prej 104.00 euro, si dhe shpenzimet e tjera që mund të krijohen varësisht nga zhvillimi i procedurës civile.

Gjykata, pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në nenin 8, lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në **tërësi e bazuar**.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse është jokontestues fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune, në pozitën mësimdhënëse tek e paditura dhe ka arritur moshën e pensionimit me datë 27.04.2022 ( kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës). Kjo vërtetohet edhe nga Vendimi Nr.163

i datës 07.04.2022, i lëshuar nga Komuna Rahovec-DKA dhe Vërtetimi me nr.prot. 205/2022, i datës 19.04.2022, i lëshuar nga SHML “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec.

Nga lista e pagave – Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se paditësja deri me datë 27.04.2022 kishte 40 vite përvojë pune dhe realizonte pagën neto në shumë prej 543.85 euro në muaj.

Neni 90 par. 5 i Ligjit të Punës Nr.03/L-212, përcakton se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive.”*

Neni 35 par.8 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, përcakton që: *“punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit”* nënpar. 8.1 *“për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë”* nënpar. 8.2 *“për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë”* nënpar. 8.3 *“për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë”* nënpar. 8.4 *“për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë”* dhe 8.5 *“Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse”,* ndërsa neni 35 par. 9 përcakton që: *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit.”*

Pra, në pajtueshmëri me dispozitën ligjore të lartcekur është paraparë detyrimi i punëdhënësit, në rastin konkret të paditurës, për kompensimin e pagesës përcjellëse dhe shpërblimit jubilar, për shkak se Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e njëjta prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë. Në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit (mësimdhënësit) dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë në raport me të punësuarit e saj në arsim.

Andaj, gjykata e aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses lidhur me kërkesën për pagesën e shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim që paditëses në emër të kompensim të shpërblimit jubilar t’ia paguaj shumën prej 815.78 Euro, (150% të pagës neto x 543.85Euro = 815.78euro), për 40 vjet përvojë pune, si dhe në emër të kompensimit të pagesës përcjellëse, t’ia paguajë në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, shumën prej 1,631.55 Euro (një mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një euro e pesëdhjetë e pesë cent) euro, (paga neto 543.85 euro, ashtu që 543.85 x3=1,631.55), duke u bazuar në listën e pagave të Buxhetit të Republikës së Kosovës

Gjykata me rastin e vendosjes (jashtë seancës gjyqësore) është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë e përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* dhe në dispozitën e nenit 399.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*

Bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit ishte qartazi e themeltë dhe ka bazë në dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, neni 35 par. 8 dhe 9 ndërsa shuma e kompensimit bazohet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe në bazë të nenit 399.1 të LPK-së.

Pretendimet e të paditurës se i mungon legjitimiteti pasiv në procedurë janë të pabazuara, me arsyetimin se Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e njëjta prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë. Në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit (mësimdhënësit) dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë në raport me të punësuarit e saj në arsim. Pretendimet se kontrata nuk prodhon efekt juridik për shkak se është shkëputur dhe se kërkesa e paditëses është parashkruar nuk qëndrojnë ngase Kontrata Kolektive të datës 22.01.2021 prodhon efekt juridik deri me datë 21.11.2022 (koha e shkëputjes së njëanshme), periudhë që mbulon periudhën nga kërkesëpadia. Sa i përket pretendimeve se kërkesa është parashkruar, kjo nuk qëndron ngase paditësja ka parashtruar padi me datë 22.07.2022, ndërsa kërkesa përfshinë vitin jubile të 40 (dyzetë) i cili ka arritur në vitin 2022 dhe pagat përcjellëse për pensionim i cili ka arritur me datë 27.04.2022, pra brenda afatit 3 (tre) vjeçar, ashtu siç e përcakton neni 87 i Ligjit të Punës. Mbi këtë bazë padia është e afatshme dhe kërkesa nuk është parashkruar.

Gjykata analizoi edhe pretendimet tjera të të paditurës, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk kanë impakt në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Vendimin lidhur me kamatën prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, dhe e njëjta llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, e që e paditura është obliguar që paditëses si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 135.00 euro dhe atë: 104.00 euro në emër të përpilimit të padisë dhe 31.00 euro në emër të taksës gjyqësore për padi.

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 398, lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**  
**C.nr.458/2022, datë 19.03.2024**

**G j y q t a r i**  
**Besmir Juniku**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë – Divizioni Civil.